

Hajrullah Fejza, PhD, është Profesor i Asociuar në UBT dhe seksolog klinik i certifikuar, me përvojë të gjerë në shkencat mjekësore, epidemiologji dhe mjekësinë seksuale. Ai ka përfunduar doktoraturën në Seksologji Klinike në American Academy of Clinical Sexologists dhe ka të përfunduar Masterin e Shkencave Mjekësore në Universitetin e Prishtinës. Në fushën akademike, ligjëron lëndën *Human Sexuality* dhe kontribuon në kërkime klinike, epidemiologjike dhe të shëndetit publik.

Dr. Fejza ka botuar gjerësisht në revista ndërkombëtare, duke trajtuar tema si shëndeti seksual, raportet klinike, sëmundjet infektive, epidemiologjia dhe cilësia e shërbimeve shëndetësore. Punimet e tij janë publikuar në revista si *The Journal of Sexual Medicine*, *International Journal on Minority and Group Rights*, *IIUM Medical Journal Malaysia*, *EJCRIM*, *Infectious Disease Reports* dhe të tjera.

Me mbi një dekadë përvojë menaxheriale dhe profesionale përfshirë punën në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, Komunën e Prishtinës dhe Ministrinë e Shëndetësisë, ai ka kontribuar në sigurimin e cilësisë në shëndetësi, zhvillimin e politikave të shëndetit publik dhe hartimin e udhëzimeve klinike. Ai është anëtar i disa organizatave profesionale, përfshirë American Board of Sexology, European Society for Sexual Medicine (ESSM) dhe European Federation of Sexology.